

VENDIM
Nr.1223, datë 11.12.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 13 dhjetor 2009, të një autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 1 (një) automjet dhe 5 (pesë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 14 dhjetor 2009, të një autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 13 dhjetor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 14 dhjetor 2009, është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha